



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RREGULLORE
PËR AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE MATEMATIKE
DHE LLOJET E INVESTIMEVE TË LEJUARA TË KËTYRE AKTIVEVE

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 200, datë 27.12.2016

Neni 1

Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i:

- a) Llojeve dhe karakteristikave të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike;
- b) Parimeve dhe rregullave të investimit nga shoqëritë e sigurimit/risigurimit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në klasat e sigurimit të Jetës;
- c) Kategorive të tjera të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike;
- d) Rregullave për diversifikimin dhe kufizimin në lidhje me investimin e aktiveve, vlerësimin e tyre, si edhe mënyrat dhe afatet e raportimit në Autoritet.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 98, pika 4, nenit 103, pika 1, germa ë) nenit 103, pika 5 dhe nenit 104, pika 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Politika e investimit

1. Shoqëria e sigurimit duhet të garantojë që vlera e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike të jetë në çdo kohë e njëjtë me shumën e mbulimit të kërkuar për provigjonet e

klasave të sigurimit të Jetës, përfshirë (i) provigjonet matematike, (ii) provigjonet për primet bruto të pafituara, (iii) provigjonet bruto të dëmeve dhe (iv) provigjonet për bonuset dhe rabatet në lidhje me sigurimin e Jetës. Në kuptim të kësaj rregulloreje, aktivet në mbulim të provigjoneve matematike nënkuptojnë aktivet që mbulojnë përgjegjësinë që rrjedh nga klasat e sigurimit të Jetës.

2. Në funksion të madhësisë, natyrës dhe kompleksitetit të aktivitetit që kryen, shoqëria e sigurimit përcakton politika investimi të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike në përputhje me profilin e riskut. Në përzgjedhjen e investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, shoqëria e sigurimit synon të garantojë sigurinë, përfitimin, tregtueshmërinë, diversifikimin dhe shpërndarjen e investimeve në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës.

Neni 4 **Siguria e investimeve**

1. Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike duhet të vlerësohet sipas aspekteve ekonomike dhe ligjore të sigurisë.
2. Aspekti ekonomik i sigurisë nënkupton gjykimin e sigurisë së investimit bazuar në:
 - a) Vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe klasifikimin e rrezikut të kreditit për emetuesin e instrumenteve financiare apo huamarrësin e shoqërisë së sigurimit;
 - b) Vlerësimin për luhatje sa më të ulët në vlerën e aktiveve të investuara;
 - c) Gjykimin mbi tregtimin në tregjet e rregulluara apo mënyrat e tjera të tregtimit;
 - d) Vlerësimin e kujdesshëm dhe konsistent të aktiveve me metoda të përshtatshme të vlerësimit.
3. Aspekti ligjor i sigurisë së investimit nënkupton kontrollin e pakufizuar të shoqërisë së sigurimit mbi aktivet e investuara, përfshirë edhe mundësitë për tregtimin dhe transaksionet e fondeve me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve.

Neni 5 **Përfitimi nga investimet**

Investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike duhet të synojë arritjen e normave të kthimit në përputhje me tendencat e tregut.

Neni 6

Tregtueshmëria e investimeve

Aktivet në mbulim të provigjoneve matematike janë të tregtueshme, në qoftë se mund të shkëmbehen me para ose mjete të barasvlefshme me to. Shoqëria e sigurimit duhet të përzgjedhë investime që janë të tregtueshme brenda një periudhe të shkurtër kohe në vlerën e drejtë të tyre.

Neni 7

Diversifikimi dhe shpërndarja e investimeve

1. Shoqëria e sigurimit duhet të udhëhiqet nga parimet e diversifikimit dhe shpërndarjes së investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, me qëllim ruajtjen e vlerës dhe kufizimin e rrezikut të humbjes në investime, në mënyrë që çdo lloj aktivi, tregu apo investimi të mos ketë ndikim negativ të konsiderueshëm në strukturën e përgjithshme të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike. Shoqëria e sigurimit përcakton personat, rolet dhe funksionet e tyre në rregulloren e saj të brendshme të investimeve.
2. Në përzgjedhjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, shoqëria e sigurimit duhet të ketë parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) Diversifikimin e investimeve në instrumente financiare të emetuar nga emetues të ndryshëm;
 - b) Diversifikimin në huamarrës të ndryshëm për huatë e lëvruara nga shoqëria e sigurimit;
 - c) Diversifikimin në aktivitete biznesi të ndryshme të emetuesve apo huamarrësve;
 - d) Vlerësimin e rreziqeve të lidhura me emetuesit apo huamarrësit (p.sh. rreziku i humbjes apo uljes së vlerës për një lloj të caktuar aktivi);
 - e) Normën e parashikuar të kthimit nga investimi;
 - f) Kohëzgjatjen e investimit;
 - g) Ndërlidhjen midis llojeve të ndryshme të investimeve.

Neni 8

Rregullat e brendshme të investimit

1. Në kuadër të politikës dhe procedurave të administrimit të rrezikut, shoqëria e sigurimit miraton rregulloren e saj të brendshme të investimeve që përcakton strategjinë, parimet, procedurat, monitorimin dhe raportimin e investimeve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Rregullorja e brendshme e investimeve të shoqërisë së sigurimit përfshin:
 - a) Parimet dhe objektivat e investimeve të shoqërisë;
 - b) Metodot e vlerësimit;
 - c) Kufizimet dhe vlerat e lejuara të përcaktuara mbi bazën e vlerësimit të rreziqeve të veçanta;
 - d) Përshkrimin e procedurave të investimit;
 - e) Strukturën organizative dhe përcaktimin e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive të njësisë të lidhura me investimet, përfshirë përshkrimin e detyrave dhe njohuritë profesionale dhe kualifikimet e personave përgjegjës për investimet;
 - f) Metodot e monitorimit të investimeve, si edhe linjat e raportimit të brendshëm dhe afatet e raportimit të investimeve;
 - g) Krijimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për evidentimin në kohë të rreziqeve potenciale dhe marrjen e masave për parandalimin dhe përqendrimin e tyre;
 - h) Rregullat mbi organizimin, ruajtjen dhe disponueshmërinë e dokumentacionit të investimeve, veçanërisht atij të lidhur me huatë, tokat e ndërtesat;
 - i) Rregullat e brendshme për përputhjen e aktiveve me përgjegjësitë dhe procedurat për analizën e përputhjes së aktiveve me provigjonet matematike.
3. Shoqëria e sigurimit duhet të ketë një strukturë të përshtatshme organizative që mundëson zbatimin e politikave dhe rregullave të investimeve.
4. Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit të marrë masa për përshtatjen e investimeve në përputhje me politikat dhe rregullat e saj, në rast të konstatimit se investimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike nuk është kryer në përputhje me rregulloren e brendshme të investimit.

Neni 9

Kategori të tjera investimi të aktiveve lejuara në mbulim të provigjoneve matematike

1. Shoqëria e sigurimit përveç parashikimeve të nenit 103 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", lejohet të mbulojë provigjonet matematike edhe me aktivet e listuara më poshtë:

- a) Hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që:
- I. Garancitë bankare ose siguruese të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon edhe shoqërinë;
 - II. Dhënia e huave të bazohet në rregulla të qarta mbi mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të rrezikut të kreditit të huamarrësit potencial, bazuar në pasqyrat financiare të huamarrësit të audituara për të paktën tre vitet e fundit dhe cilësinë e garancisë;
 - III. Vlera e huasë për llogari të shoqërisë së sigurimit nuk kalon 20 përqind të aktiveve neto të huamarrësit, sipas pasqyrave të tij të fundit financiare të audituara;
 - IV. Të paktën një herë në vit shoqëria e sigurimit të kontrollojë dhe përditësojë të dhënat mbi rrezikun e kreditit për huamarrësin deri në shlyerjen e plotë të huasë;
 - V. Huamarrësi të mos ketë detyrime të prapambetura pagesash të principalit dhe/ose interesave të huasë për më shumë se 6 muaj;
 - VI. Garancitë hipotekore të jenë të lira nga çdo barrë apo peng tjetër dhe vlera e huasë të mos jetë më shumë se 60 përqind e vlerës së pronës vlerësuar nga vlerësues të autorizuar të pasurive të paluajtshme. Pasuritë e paluajtshme të nënshtrohen vlerësimit nga vlerësues të autorizuar të pasurive të paluajtshme, çdo 24 muaj nga momenti i marrjes së huasë;
 - VII. Shoqëria e sigurimit të verifikojë dhe mbajë si evidencë dokumentat e mëposhtëm të lidhur me garancinë hipotekore:
 - i. Të dhënat e hipotekës për pronën që përdoret si garanci hipotekore;
 - ii. Marrëveshjen e huasë;
 - iii. Kontratën e sigurimit të pronës që përdoret si garanci hipotekore;
 - iv. Vlerësimin e kolateralit nga vlerësues të autorizuar të pasurive të paluajtshme.
 - VIII. Shoqëria e sigurimit të mbajë të dhëna të detajuara për çdo huamarrës, përfshirë:
 - i. Vendimin për dhënien e huasë;
 - ii. Marrëveshjen e huasë;
 - iii. Vlerësimin e rrezikut të kreditit të shoqëruar me dokumenta mbështetës;
 - iv. Garancinë bankare, siguruese apo hipotekore;
 - v. Dokumenta të tjera në përputhje me rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- b) Shumat që detyrohen nga risiguruesit të mbështetura me evidencë, në rast se nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë;
- c) Pjesën e risiguruesit në provigjonet matematike;

- d) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;
 - e) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, në rast se nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë;
 - f) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;
 - g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në nenin 103, pika 1, germa “f”, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të vlerësuar në bazë të normave të amortizimit.
 - h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.
2. Me miratimin paraprak të Autoritetit, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 103, të Ligjit 52/2014, aktivet në mbulim të provigjoneve matematike, mund të investohen edhe në:
- a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar i BE-së ose vend anëtar i OECD-së që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor’s ose vlerësimeve të barasvlefshëm me të;
 - b) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar të BE-së ose vendi anëtar të OECD-së me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor’s ose vlerësimeve të barasvlefshëm me të, nëse për këto instrumente ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;
 - c) Aksione të listuara të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar të BE-së ose vend anëtar të OECD-së që është e klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor’s ose vlerësimeve të barasvlefshëm me të;
 - d) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar të BE-së ose vend anëtar të OECD-së, me kusht që këto sipërmarrje nuk janë regjistruar në zona off-shore.
3. Nuk do të konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve matematike për shoqërinë e sigurimit:
- a) Aktivet që shërbejnë për financimin e kapitaleve të veta të shoqërisë së sigurimit, apo të një subjekti tjetër që është objekt kufizimesh rregullative nga një Autoritet Mbikëqyrës, brenda të njëjtit grup kapitali;
 - b) Letrat me vlerë të shoqërive të cilat janë filiale, shoqëri mbështetëse, aksionarë, në

shoqërinë e sigurimit apo çdo rast tjetër që konsiderohet si palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit;

- c) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim;
- d) Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura dhe huatë nga brokerat dhe agjentët;
- e) Shpenzime të parapaguara;
- f) Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit si dhe kërkesë pagesa që rrjedhin nga pjesët e shpëtuara dhe subrogimet;
- g) Çdo investim tjetër sipas gjykimit të Autoritetit.

Neni 10

Diversifikimi dhe kufizimi i investimeve të aktiveve të lejuara në mbulim të provigjoneve matematike

Shoqëria e sigurimit përsa i përket aktiveve dhe investimeve të aktiveve të lejuara në mbulim të provigjoneve matematike, mund të investojë jo më shumë se:

- a) 70 për qind të provigjoneve matematike bruto në letra me vlerë të listuara, si dhe letra me vlerë të tregtuara në tregje të rregulluar dhe pjesëmarrje në sipërmarrje të investimeve kolektive;
- b) 25 për qind të provigjoneve matematike bruto në toka dhe ndërtesa, përfshirë 10 për qind në çdo pjesë toke a ndërtese ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra-tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht një investim;
- c) 70 për qind të provigjoneve matematike bruto në aktivet e përcaktuara në pikën a) dhe b) të këtij neni të marra së bashku;
- d) 10 për qind të provigjoneve matematike bruto në, letra borxhi, obligacione të garantuara me aktive dhe në aksione që nuk janë të listuara, si dhe të tjera letra me vlerë me të ardhura fikse apo të ndryshueshme, me kusht që investimi i shoqërisë së sigurimit në një subjekt që emeton këto letra me vlerë nuk tejkalon 10 për qind të kapitalit të këtij të fundit;
- e) 5 për qind të provigjoneve matematike bruto në aksione dhe letra me vlerë të listuara, si dhe letra me vlerë të tregtuara në një treg të rregulluar dhe pjesëmarrje në sipërmarrje të investimeve kolektive, si: aksione, obligacione dhe instrumente të tjera të tregut të parasë dhe kapitalit të së njëjtës sipërmarrje apo hua, dhënë të njëjtit huamarrës. Ky kufi mund të rritet në 10 për qind nëse sipërmarrja nuk investon më shumë se 40 për qind të provigjoneve matematike bruto në hua ose letra me vlerë të institucioneve emetuese a huamarrëse, ku në secilën prej tyre ka investuar më shumë se 5 për qind të aktiveve të veta;
- f) 50 për qind të provigjoneve matematike bruto në depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;

- g) 5 për qind të provigjoneve matematike bruto në hua të pasiguruar, përfshirë 1 për qind për çdo hua të vetme;
- h) 15 për qind të provigjoneve matematike bruto në hua të siguruar, përfshirë 5 për qind për çdo hua të vetme;
- i) 15 për qind të provigjoneve matematike bruto për kreditë hipotekore, përfshirë 5 për qind të provigjoneve matematike neto për çdo kredi të vetme;
- j) 20 për qind të provigjoneve matematike bruto për aktivet e përcaktuara në pikën g), h) dhe i) të marra së bashku;
- k) 25 për qind e vlerës së provigjoneve matematike në shuma që detyrohen nga ceduesit, risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provigjonet matematike. Nuk pëfshihen në këtë kufizim provigjonet e risigurimit apo shumat që detyrohen nga risigurues me klasifikim BBB+ e më lart nga Standart & Poors ose të barasvlefshëm me të;
- l) 20 për qind të provigjoneve matematike bruto në depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;
- m) 20 përqind të provigjonit të primit të pafutuar për shuma që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese;
- n) 3 për qind të provigjoneve matematike bruto në formën e parasë dhe ekuivalentëve të saj;
- o) 5 për qind të provigjoneve matematike bruto në aktive të qëndrueshme të trupëzuara, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën b) të po këtij neni;
- p) 5 për qind të provigjoneve matematike bruto në interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara;
- q) 25 përqind të provigjoneve matematike bruto për aktivet e përcaktuara në pikën j) deri o) të marra së bashku.

Neni 11

Kriteret e përdorimit të instrumentave financiare derivative në lidhje me aktivet në mbulim të provigjoneve matematike

1. Shoqëria e sigurimit mund të përdorë instrumente financiare derivative në lidhje me aktivet në mbulim të provigjoneve matematike nga subjekte me klasifikim të investimeve afat të mesëm dhe të gjatë BBB+ e më lart nga Standart & Poors ose të barasvlefshëm dhe të licencuar në vendet e Bashkimit Europian dhe OECD, vetëm në rast se këto instrumenta:

- a) Tregtohen në tregje të rregulluara;
 - b) Kontribuojnë në zvogëlimin e rrezikut të investimit duke mbrojtur vlerën e aktivitet apo provigjionit nga ndryshimet negative në normat e interesit, kurset e këmbimit ose çmimet e tregut. Në rast të përdorimit të këtyre instrumentave, shoqëria duhet të vërtetojë qëllimin nëpërmjet dokumentacionit teknikisht të verifikueshëm të bazuar në një lidhje të ngushtë të karakteristikave financiare të aktiveve dhe përgjegjësi me ato të instrumentave financiare derivativa;
 - c) Kanë lidhje të qartë tekniko-financiare me aktivet që mbulojnë provigjionet matematike apo përzgjidhen për këtë qëllim bashkë me operacionet për blerjen e instrumentave financiare;
 - d) Vlerat e tyre diktohen nga aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve matematike, ose nga indekse të bazuara në këto lloj aktivesh.
2. Vlera e instrumentave financiare derivativa sipas kriterëve të mësipërme merren parasysh për vlerësimin e aktiveve të lidhura me to.
 3. Në rast se pozicioni i instrumentit derivativ është i hapur në datën e raportimit, çdo marzh pozitiv (në lidhje me vlerën e tregut) mund të konsiderohet në vlerësimin e aktiveve në mbulim të provigjioneve matematike të lidhura me këto instrumenta, vetëm nëse ky marzh kompenson tërësisht apo pjesërisht zhvlerësimin e aktiveve të llogaritur në pasqyrat financiare. Marzhi negativ mund të konsiderohet në vlerësimin e aktiveve në mbulim të provigjioneve të lidhura me këto instrumenta, në masën e axhustimit të mundshëm të vlerës së aktiveve të llogaritur në pasqyrat financiare.
 4. Kriteret e përdorura për vlerësimin e instrumenteve financiare derivative që përfaqësojnë aktivet ose përgjegjësitë e shoqërisë së sigurimit duhet të jenë në çdo rast në përputhje me metodat e përdorura për përcaktimin e vlerës së aktiveve të lidhura me to.

Neni 12

Aktivet në mbulim të provigjioneve matematike të kontratave ku i siguruari mban rrezikun e investimit

Llojet e investimeve dhe kufizimet e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjioneve matematike, sipas klasave të sigurimit të Jetës, ku i siguruari mban rrezikun e investimit dhe kur të drejtat që rrjedhin nga kontrata e sigurimit të Jetës të të siguarit janë të njëjta me kategoritë e investimit, diversifikimin dhe kufizimin e investimeve të parashikuara në nenin 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Vlerësimi i aktiveve

1. Aktivitet në mbulim të provigjoneve matematike duhet të vlerësohen në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të përkthyer në shqip, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pa ndryshime nga teksti origjinal në gjuhën angleze dhe të shpallura nga Ministri i Financave.
2. Letrat me vlerë të emetuara apo aktivet e investuara në shoqëri që janë shpallur pa aftësi paguese apo për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit regjistrohen me vlerë zero tek aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.

Neni 14

Përputhja e aktiveve

1. Totali i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike sipas të gjitha monedhave në të cilat janë shprehur aktivet, duhet të jetë jo më i vogël se totali i provigjoneve matematike të kombinuara në të gjitha monedhat. Në rast se mbulimi në sigurim është shprehur në një monedhë të caktuar, detyrimet e shoqërisë së sigurimit konsiderohen të pagueshme në këtë monedhë.
2. Shoqëria e sigurimit i paraqet aktivet në mbulim të provigjoneve matematike bazuar në parimin e përputhjes sipas të cilit provigjonet matematike dhe aktivet përkatëse duhet të jenë të përputhura sipas monedhave për të garantuar që çdo ndryshim në vlerën e përgjegjësisë për shkak të luhatjeve në monedha shoqërohet lëvizjet përkatëse në vlerën e aktiveve përkatëse.
3. Shoqëria e sigurimit lejohet të mbulojë provigjonet matematike të pagueshme në një monedhë të caktuar me aktive të shprehura në monedha të ndryshme nga monedha e pagesës së detyrimeve, në rast se këto provigjone llogariten jo më shumë se 7 përqind e totalit të provigjoneve të shprehura në monedha të tjera.
4. Shoqëria e sigurimit lejohet të mbulojë jo më shumë se 20 përqind të totalit të provigjoneve matematike të shprehura në një monedhë të caktuar me aktive të shprehura në monedha të tjera.
5. Shoqëria e sigurimit monitoron dhe kryen rregullisht analiza të përputhjes së aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.

Neni 15

Raportimi dhe pajtueshmëria

1. Shoqëria e sigurimit kryen raportimin periodik të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike sipas afateve, mënyrës dhe formateve të përcaktuara nga Autoriteti me rregullore të

veçantë.

2. Raportimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike kryhet për gjendjen në ditën e fundit të çdo tremujori (31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor) brenda 30 ditëve nga fundi i tremujorit përkatës.
3. Shoqëria e sigurimit pasqyron në raportin vjetor mbi gjendjen e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike më 31 dhjetor brenda tre muajve nga fundi i vitit të raportimit.
4. Aktivitet që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë rregullore nuk konsiderohen të lejueshme për të mbuluar provigjonet matematike. Në rast se Autoriteti konstaton se parashikimet e kësaj rregulloreje nuk janë përmbushur në lidhje me një apo disa lloj aktivesh, ai informon shoqërinë për mos pranimin e këtyre aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike.
5. Shoqëria e sigurimit njofton Autoritetin brenda tetë ditëve kalendarike nga konstatimi se aktivitet në mbulim të provigjoneve matematike nuk janë investuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe parashikimet e kësaj rregulloreje dhe merr masa për të garantuar përputhshmërinë.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.